


**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE SE
BASHKEPUNIMIT BUJQESOR
“PATATJA E SHISHTAVECIT”**

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme
Shishtavec, Kukës Dt 28/01/2025

A series of handwritten signatures in blue ink, likely representing the members of the General Assembly, located at the bottom of the document.

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE SE BASHKEPUNIMIT BUJQESOR "PATATJA E
SHISHTAVECIT"

Në mbështetje të ligjit nr. 38, datë 05.04.2012, "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor", si dhe ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", hartohet ky akt themelimi nga anëtarët e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor "PATATJA E SHISHTAVECIT":

1. Jelen Hoxha me ID F70301076I
2. Fidane Hoxha me ID H65307207E
3. Ymer Noka me ID G50630027T
4. Mexhit Noka me ID J40901049H
5. Arben Beqaj me ID G90503036W
6. Pajtim Beqaj me ID H70511037A
7. Shahin Biba me ID H70101286A

Kjo shoqëri është një organizatë e krijuar me vullnetin e lirë të anëtarëve të saj, e pavarur dhe jo politike.

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi i shoqërisë do të jetë Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor "PATATJA E SHISHTAVECIT".

NENI 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqëria në objekt të ushtrimit të veprimtarisë së saj do të ketë:

- 1) Mbjelljen, rritjen, prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe konservimin e patates dhe të produkteve të tjera bujqësore që zhvillohen në zonën e Shishtavecit dhe në rajonin e Kukësit.
- 2) Mbledhjen, grumbullimin dhe përpunimin e produkteve të rritura në kushte natyrore në pyje, si gështenja, manaferrat, bimët mjekësore dhe frutat e tjera të egra që gjenden në këtë rajon.
- 3) Kultivimin, përpunimin dhe konservimin e produkteve të veçanta, përfshirë bimët karakteristike dhe të përshtatshme për klimën dhe terrenin e Shishtavecit, si edhe produkteve të tjera që mund të zhvillohen në mënyrë bio dhe organike.
- 4) Mbarështimin e blegtorisë, duke përfshirë rritjen dhe kujdesin për gjedhët, dhitë, delet dhe kafshët e tjera, si edhe përpunimin e produkteve blegtorale, si qumështi,

djathi, mishi dhe nënproduktet e tyre, për të krijuar vlerë të shtuar dhe për të përmirësuar tregtimin e tyre në tregje lokale dhe kombëtare.

- 5) Importin dhe eksportin e produkteve bujqësore dhe blegtorale të përpunuara dhe gjysmë të përpunuara, të freskëta ose të konservuara, duke përfshirë blerjen e farërave cilësore, fidanave, dhe produkteve mbrojtëse për bujqësinë, si edhe ushqimet e kafshëve dhe suplementet për blegtorinë.
- 6) Ngritjen e industrisë përpunuese për pataten, produktet bujqësore dhe blegtorale, përfshirë paketimin, përpunimin dhe ruajtjen e tyre për të siguruar vlerën dhe cilësinë e produkteve.
- 7) Përmirësimin dhe organizimin e metodave të kultivimit dhe mbarështimit, për pataten, grurin, bimët foragjere dhe blegtorinë, me qëllim rritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimit, si edhe për të lehtësuar tregtimin e këtyre produkteve.
- 8) Nxitjen dhe organizimin e aktiviteteve që lidhen me prodhimin dhe tregtimin e produkteve të fermerëve dhe blegtorëve nga Shishtavec i dhe fshatrat përreth, duke krijuar mundësi për bashkëpunim dhe promovim të përbashkët.
- 9) Sigurimin dhe furnizimin e fermerëve dhe blegtorëve me imputet e nevojshme, duke përfshirë fara të certifikuara, ushqime për kafshët, pajisje dhe teknologji bashkëkohore, me çmime të favorshme dhe në kohë. Si dhe Objekti i veprimtarisë së shoqërisë konsiston në:
 - ✦ Ofirimi i shërbimeve me koston e tyre dhe jo me vlerën e tregut;
 - ✦ Përmbushja e qëllimeve dhe nevojave të anëtarëve të vetë shoqërisë;
 - ✦ Rritjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral të fermerëve në treg;
 - ✦ Promovimin e eksporteve;
 - ✦ Konsolidimi i kanaleve të marketingut bujqësor;
 - ✦ Institucionalizimi i bashkëpunimit në bujqësi;
 - ✦ Reduktimi i efekteve negative të ndikimit të fermës së vogël në Shqipëri;
 - ✦ Zgjidhja e problemit të fermave të vogla dhe të pafuqishme financiarisht;
 - ✦ Zvogëlimi i aktiviteteve informale;
 - ✦ Përfitimin e granteve qeveritare dhe atyre në bashkëpunim nga një numër sa më i madh fermerësh.

NENI 3

SELIA DHE TERRITORI I VEPRIMTARISE

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Fshati Shishtavec, Lagjia Hoxha, Rruga Hoxha, Ndërtesë private nr.4 Hyrja 1.

Veprimtaria e saj do të shtrihet në territorin e Komunës Shishtavec, në Njësinë Administrative dhe Qarkun e Kukësit, si dhe në çdo zonë ku shtrihet anëtarësia e saj.

NENI 4

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.

NENI 5

KAPITALI

Kapitali i Shoqërisë përbëhet minimalisht nga 100,000 (njëqind mijë) lekë dhe ndahet në përqindje sipas kontributit të secilit anëtar. Kapitali mund të kontribuohet në para të gatshme ose në formën e kontributeve në natyrë (si objekte, tokë apo makineri).

Kontributet në natyrë shprehen në vlerë ekonomike, bazuar në një raport vlerësimi të përgatitur nga një ekspert i caktuar nga Asambleja e Anëtarëve.

Anëtarët janë pronarë të aseteve që ata kontribuojnë në kapitalin e Shoqërisë, duke qenë kështu edhe pronarë të Shoqërisë në përpjesëtim me kontributet e tyre në kapital.

Kapitali përkatës mund të shitet, dhurohet ose lihet në trashëgimi nga secili prej anëtarëve të Shoqërisë.

Në momentin e krijimit të Shoqërisë, kapitali fillestar është i ndarë si më poshtë:

Antari	ID	Kuota	Përqindja e zotëruar	Kontributi në lek
Jelen Hoxha	F70301076I	1	30	30 000
Fidane Hoxha	H65307207E	1	30	30 000
Ymer Noka	G50630027T	1	30	30 000
Mexhit Noka	J40901049H	1	3	3 000

Arben Beqaj	G90503036W	1	3	3 000
Pajtim Beqaj	H70511037A	1	2	2 000
Shahin Biba	H70101286A	1	2	2 000
Totali		7	100 %	100 000
				Lek

NENI 6

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISË

Organet dejtuese të shoqerisë:

1. Asambleja e Pergjithshme e Anetareve;
2. Administratori i cili me vendim të Asamblese mund të qendrojë në detyrë për një periudhë kohe maksimale jo më shumë se 5 vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Administratori i miratuar nga mbledhja themeluese e Shoqerisë emerohet Z. Jelen Hoxha, i cili emerohet Administrator për një periudhë 5 vjeçare.

Administratori ngarkohet me kryerjen e të gjitha procedurave të regjistrimit të Shoqerisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 7

MENYRA E SHPERNDARJES SE SHOQERISE

Shoqeria shpërndahet me vendim të mbledhjes së përgjithshme të thirrur nga Administratori.

Procedura e ndjekur për shpërndarjen e saj përcaktohet në Statusin e Shoqerisë. Shoqeria shpërndahet në këto raste;

- ✚ Kur numri i anetareve është nën shtatë vota.
- ✚ Kur qëllimi i saj është përmbushur apo nuk ka mundësi të përmbushet, pasi ka humbur aftësi paguese.
- ✚ Në rast shpërndarjeje të shoqerisë, ajo pushon veprimtarinë e saj dhe vihet në likuidim nga komisioni i likuidimit i cili formohet sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Ky akt themelimi hyn ne fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në QKR. Në këtë ditë shoqëria njihet edhe si person juridik.

Të drejtën e përfaqësimit në gjykatë të shoqëritës për të bërë regjistrimin e saj e ka Administratori i saj ose një person i autorizuar prej tij.

PERFAQESIA THEMELUESE

1. Jelen Hoxha



2. Fidane Hoxha



3. Ymer Noka



4. Mexhit Noka



5. Arben Beqaj



6. Pajtim Beqaj



7. Shahin Biba

